



Nr.No.Br.

02/ 183

REPUBLIKA KOSOVA
SHEVE

OPSTINA OPSTINE MALISEVO

04.04.2023



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Kryesuesi i Kuvendit

Nr.02/ _____

Datë: 04.04.2023.

Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (c), nenit 17, nenit 40 paragrafi 2 shkronja (a), të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr.28/2008” Statutit të komunës së Malishevës, nenit 12,19, par.19.1 shkronja (a),

Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e tretë (III) të rregullt të mbajtur me datë: 30.03.2023 merr këtë:

VENDIM

1. Miratohet Rregullorja për Transportin Publik Urban , në territorin e komunës së Malishevës.
- 2.Me këtë Rregullore përcaktohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Komunës së Malishevës.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes drejtorive kompetente në kuadër të Komunës së Malishevës.
- 4.Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040,Vetëqeverisjen Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.10/2019 për Shqyrtimin e Administrativ të Akteve të Komunave, dhe pas shpalljes në ueb-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet :

MAPL-së

Arkivit të Komunës

Kryesuesi i Kuvendit





REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVE-GRUPETINA OŠTINE MALISHEVO



PRANUAR ME:
ACCEPTED ON: 03.04.2023
PRIMLJENO
Nr.No.Br. 02/175

REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

R R E G U L L O R E

PËR TRANSPORTIN PUBLIK URBAN

Malishevë, 2023

Në mbështetje të Ligjit Nr. 03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, neni 11, neni 12 paragrafi 2 shkronja (c), neni 40 , Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor, neni 6 paragrafi 5 , neni 7 pika 8, neni 15 paragrafi 2, Ligji për Kundërvajtje (Ligji Nr.05/L-087) neni 29, Statutit të Komunës së Malishevës, Nr.01/871 të datës 12/11/2008, Kuvendi i Komunës së Malishevës, në mbledhjen e mbajtur më _datë ____/____/2023 , miratoi këtë:

R R E G U L L O R E

PËR TRANSPORTIN PUBLIK URBAN

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

Me këtë Rregullore përcaktohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e Komunës së Malishevës (vazhdim “Komuna”), lejimi, ndalimi i përdorimit të kompanive publike transportuese (autobus,minibus), Auto Taxi.

Neni 2

Fushëveprimi

Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në tërë territorin e Komunës së Malishevës.

Neni 3

Kompetencat e Komunës në sektorin e transportit

1. Kuvendi i Komunës së Malishevës, me propozim të Kryetarit të Komunës:
 - 1.1 përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit të sigurt, efikas dhe ekonomik brenda territorit të komunës;
 - 1.2 Të nxjerr planin e transportit dhe e ndryshon atë sipas nevojës dhe rrethanave të krijuara;
 - 1.3 publikon planin, planin e ndryshuar, dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë kompetente
 - 1.4 plani duhet të jetë në përputhje me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit publik në Republikën e Kosovës.

Neni 4

Kushtet për operatorët e transportit rrugor në territorin e komunës së Malishevës

- 1.Te drejt për të ushtruar veprimtarinë e tyre afariste kanë vetëm : Operatorët-kompanit e transportit të udhëtarëve, Autotaksit, që janë të regjistruar si biznese, dhe posedojn Vendime valide për ushtrimin e veprimtarisë së tyre në territorin e komunës së Malishevës.
 - 1.1 Keta operator janë të detyruar :të përdorin mjete të transportit, që janë teknikisht në gjendje të rregullt;
 - 1.2 të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese;
 - 1.3 të plotësojnë evidenca statistikore, sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;

- 1.4 të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.
2. Për marrjen e licencës- vijave urbane, të transportit rrugor të udhëtarve, operatori ekonomik duhet t'i plotësoj këto kushte;
 - 2.1 të jetë i regjistruar në regjistrin e bizneseve në organin kompetent;
 - 2.2 të ketë se paku një autobus/minibus , në pronësi të operatorit;
 - 2.3 të ketë personel të mjaftueshëm profesional për menaxhimin e kësaj veprimtarie në çdo linjë;
 - 2.4 të ketë objektin i cili i plotëson kushtet teknike për servisim;
 - 2.5 të ketë reputacion të mirë
 - 2.6 kushtet tjera të parapara sipas ligjeve dhe akteve tjera nënligjore;

Neni 5

Operatori , i cili bën transportin e rregullt publik, duhet të marrë përsipër transportin e çdo udhëtari me bagazh, të cilët nuk janë të përjashtuar nga transporti sipas rregullave të veçanta.

Neni 6

Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve me bagazh kryhet në bazë të, licencës , vendimit të rendit të udhëtimit , Vendimit për ushtrim të veprimtarisë , që lëshohen nga organet kompetente.

Neni 7

1. Operatori i transportit publik i udhëtarëve nuk mund të ushtrojë veprimtarinë para se të pajiset me Vendim për lejimin e vijave urbane (rend të udhëtimit) dhe të ushtrimit të veprimtarisë.
2. Vendimet janë të obligueshme dhe lëshohen në vlefshmëri prej tri vitesh (3) vitesh për:
 - 2.1 transportin e rregullt të udhëtarëve,
 - 2.2 transportin taksit të udhëtarëve,
 - 2.3 transportin e mallrave dhe
 - 2.4 терминалет e mallrave (stacionet e ngarkesave).
3. Licenca nuk është e nevojshme për automjetet e ndihmës së shpejtë, të zjarrfikësve dhe atyre që janë të lejuar me legjislacion të veçantë.

II. TRANSPORTI RRUGOR I UDHËTARËVE

Neni 8

1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:
 - 1.1 transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë/minibusë ,
 - 1.2 transport i lirë i udhëtarëve,
 - 1.3 transporti Auto taksit i udhëtarëve dhe
 - 1.4 transport për nevojat personale.
2. Drejtoria e Shërbimeve Publike është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit të rregullt të udhëtarëve sipas nenit 8 të kësaj rregullore.

Neni 9

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë/minibus, kryhet në relacione të caktuara (linja), sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë .
2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë vija (linja) urbane komunale.

Neni 10

Autoriteti për rregullim dhe koordinim të transportit të udhëtarëve

1. Drejtoria e Sherbimeve Publike , miraton si dhe njëkohësisht edhe i shpall te lira vijat urbane për transportin rrugor lokal-urban.
2. Komuna, përmes Kryetarit të Komunës, mund të lidhë marrëveshje me komunat tjera për rregullimin reciprok të transportit të udhëtarëve mes tyre
3. Marrëveshja e kryetarit është e plotfuqishme nëse miratohet nga Ministria e linjës.

Neni 11

Rendi i udhëtimit

1. Me rendin e udhëtimit përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor në territorin e komunës, i cili përmban:
 - 1.1 emërtimin e kompanis transportuese,
 - 1.2 relacionin e vijës urbane
 - 1.3 llojin e transportit,
 - 1.4 radhitjen e vend ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare,
 - 1.5 kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend ndalje,
 - 1.6 periudhën kohore në të cilën mbahet linja,
 - 1.7 afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
- 1.8. te jet pagesa sipas rregullores per taksa dhe tarifa komunale per çdo vit kalendarik
2. Rendi i udhëtimit vlen 3, (tri) vite.
3. Drejtoria kompetente mban regjistrin e rendit te udhëtimit të vertëtuar dhe regjistruar.

Neni 12

Transportuesi është i obliguar që transportin ta kryejë në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar në Drejtoria kompetente.

Neni 13

Fillimi i veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobus/minibus

1. Transportuesi obligohet që ta fillojë veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit, dhe atë nuk mund ta ndërpresë derisa të zgjatë afati i rendit të udhëtimit.
2. Përgjashtimisht nga paragrafi 1 i këtij neni, transportuesi mund të ndërpresë përkohësisht veprimtarinë, si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme, apo ndonjë rrethan tjetër te pa parashikuar, të cilat pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban.
3. Për ndërprerjen, nga paragrafi 2 i këtij neni, transportuesi është i obliguar që të bëjë kërkesë në Drejtori, e cila do të lëshojë vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.
4. Pa lejen e Drejtorisë, transportuesi nuk mund ta ndërpresë (pezullojë) veprimtarinë e transportit të rregullt në linjë, sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të vërtetuar.

Neni 14

1. Transportuesi rendin e udhëtimit nuk mund ta tjetërsojë, transferohet dhe as ta japë me qira.
2. Transferimin e rendit të udhëtimit e bën vetëm Drejtoria kompetente.
3. Emri i transportuesit, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në librezën e qarkullimit të autobusit dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.
4. Transportuesi është i obliguar që të mbaj vijat (vijën) urbane te caktuar nga organet komunale

5.Pavaresisht nenit 8 të kësaj rregullore për shkak se fshatrat e Komunes së Malisheves kanë konfiguracion specifik (malor) Kryetari i Komunës me Vendim mund të jep pëlqim edhe për mjete tjera për kryerjen e transportit.

Neni 15

Revokimi i rendit të udhëtimit

1. Drejtoria e cila i lëshon vijat urbane, me Vendim do të revokojë rendin e udhëtimit pas Rekomandimit nga Drejtoria e Inspektoratit ,në kushtet kur:

1.1 në afat prej 3 ditësh nga dita e fuqizimit, nuk e fillon ushtrimin e veprimtarisë;

1.2 pa miratimin e Drejtorisë, nuk e mban nisjen 3 herë brenda një muaji kalendarik

2. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.

3. Drejtoria kompetente është i obliguar që ndryshimin e rendit të udhëtimit dhe të drejtimit të transportit, ndaljen e përkohshme apo të përhershme të transportit në linjën e lejuar, paraprakisht të miratuar nga Drejtoria, ta shpallë përmes shtypit apo një mjeti tjetër të informimit.

Neni 16

Përcaktimi i çmimorës

1.Transportuesit e paraqesin çmimoren për vërtetimin e çmimit. Çmimoren e miraton drejtori i Drejtorisë, në bazë të kompetencave ligjore, përmes komisionit të formuar nga drejtoria.

2.Po ashtu edhe nëse behet në ndërkoh ndonjë ndryshim në çmimore duhet miratuar ndryshimi i çmimit sipas pikës 1 të këtij neni

3.Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që qarkullon në atë linjë.

4. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimores, të cekur në paragrafin 1, të këtij neni.

Neni 17

Bileta

Çdo udhëtar në autobus duhet të pajiset me biletë, nëse paguhet për një muaj me mujore, përveç personave me leje të veçantë të caktuar me ligj. Bileta blihet në autobus apo vende të tjera përkatëse, tek të cilat transportuesi ia ka besuar shitjen e tyre.

Neni 18

Transporti i veçantë

1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.

2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti

2.1 nxënësve dhe studentëve, nga vendbanimi deri te institucioni shkollor dhe anasjelltas,

2.2 punëtorëve, nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas dhe

2.3 invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë,

3. Lejet për transport të veçantë, përmbajnë:

3.1 relacionin,

3.2 listën e udhëtarëve,

3.3 çmimin e transportit, vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve dhe

3.4 kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.

4. Kontratën për kryerjen e transportit të veçantë e lidh transportuesi, i regjistruar si operator transporti, dhe porositiësi i shërbimeve për grupin e udhëtarëve.

5. Lejen për transport, sipas këtij neni, e lëshon Drejtoria kompetente komunale .

6. Në vend të dukshëm të pjesës së përparme të autobusit, duhet të jetë mbishkrimi "Transport i veçantë".

Neni 19

Transporti për nevoja personale

1. Operatori transportues, personi tjetër fizik/juridik dhe qytetari, i cili ka automjetin transportues, mund të kryejë transport për nevoja vetanake dhe transportin e punëtorëve të vet, ose personave të tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet, si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.
2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave, të cilin e bëjnë:
 - 2.1 ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridikë dhe fizikë, të cilët kryejnë veprimtari hoteliere;
 - 2.2 institucionet shëndetësore dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit;
 - 2.3 agjencitë turistike, personat tjerë juridikë e fizikë, të cilët kryejnë veprimtari turistike, dhe në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës;
 - 2.4 shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vet;
 - 2.5 autoshkollat, të cilat aftësojnë kandidatët për vozitës gjatë punës së tyre;
 - 2.6 operatorët transportues ose punëtorët, të cilët kryejnë shërbime të veçanta;
 - 2.7 operatorët për shërbime të aeroportit ose shoqatat tjera të shërbimeve të aeroportit, nëse kryejnë transportin e udhëtarëve nga vendndisja e tyre deri te aeroporti dhe anasjelltas.

Neni 20

Obligimet e operatorëve

1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevoja personale, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi);
2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport për nevoja personale".

Neni 21

Kushtet për automjetet

1. Të gjithë autobusët apo minibusët me të cilët kryhet transporti publik i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, sipas dispozitave ligjore.
2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik i udhëtarëve, duhet të ketë:
 - 2.1 firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore;
 - 2.2 numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës;
 - 2.3 orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, të vendosura në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit.
3. Autobusi duhet t'i plotësojë të gjitha kushtet higjieno-teknike, të përcaktuara me ligj.
4. Kur autobusi nuk bën transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt".
5. Gjatë sezonit të dimrit, para fillimit të punës në linjën e caktuar, autobusi duhet të ngrohet.

Neni 22

Në trafikun linjor transporti publik i udhëtarëve kryhet me linja të përhershme, për çdo ditë dhe gjatë tërë vitit apo në periudhë të caktuar të vitit.

Neni 23

Transparenca

Linjat-Vijat urbane të transportit publik të udhëtarëve për tërë territorin e Komunës, hapen dhe shpallen publikisht : web faqe te komunës, në tabelën e shpalljeve te komunës, ne vend te dukshen ne stacionin e autobusëve ne Malishevë.

Neni 24

Stacionet e autobusëve

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vendndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit.
2. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vendndaljet, të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.
3. Stacioni e autobusëve përkatësisht personat përgjegjës te tyre jan te obliguar ta zbatojn rregulloren e brendshme.

Neni 25

Drejtoria e miraton numrin e stacioneve që janë të destinuara për kryerjen e shërbimeve të transportit të udhëtarëve te paraqitur nga operatori transportues.

Neni 26

Stacionet dhe vendndaljet e autobusëve në linjat e përhershme me plan i cakton Drejtoria.

Neni 27

1. Stacionet dhe vendndaljet për marrjen dhe zbritjen e udhëtarëve duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, doemos duhet të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
2. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës, në pjesë të ndarë të rrugës.
3. Sipërfaqja që shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose të jetë e betonuar.

Neni 28

Vend ndaljet

1. Për rregullimin e stacioneve dhe vendndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave, kujdeset Drejtoria për shërbime publike.
2. Drejtoria për shërbime publike, mund të bëjë shkëputjen ose transferin e stacionit dhe të vendndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe të sigurisë në trafik.

Neni 29

Stacioni apo vendndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta, duhet të ketë nënpullazet.

Neni 30

Rregullsia e automjeteve

1. Automjetet me të cilat behët transporti rrugor i udhëtarëve dhe i mallrave në trafikun urban dhe urbano-periferik, duhet t'i plotësojnë kushtet teknike dhe tekniko shfrytëzuese të rregullsisë së automjeteve.

2. Automjetet duhet të kenë urdhëresë udhëtimi, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.

Neni 31

1. Çdo automjet në transportin rrugor të udhëtarëve, duhet të jetë i pajisur me aparat zjarrfikës funksional, qanten e ndihmës së shpejt, çekiçi për thyerjen e xhamave në rast rreziku dhe pajisjet tjera ndihmëse mekanike.
2. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve dhe shenjat e dymëve të hyrjes dhe të daljes.
3. Në automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera të ndaluara me ligj.

Neni 32

Rendi në stacione, vendndalje dhe në automjet

1. Automjetet patjetër duhet të ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vendndaljet e linjave të tyre.
2. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit ka për detyrë t'i njoftojë udhëtarët për këtë.

Neni 33

Rregullat për personelin dhe udhëtarët

1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
2. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit.
3. Personeli i automjetit nuk guxon të japë shenjë për nisje, derisa të konstatojë se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

Neni 34

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të respektoj etikën e veshjes, dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

Neni 35

1. Udhëtarët hyjnë në autobus përmes derës të shënuar për hyrje dhe zbresin përmes derës të shënuar për dalje.
2. Personat me nevojë të veçanta, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë edhe në dyert e daljes.

Neni 36

1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit (mujoren) apo leje tjetër valide të udhëtimit.
2. Udhëtari është i obliguar që, sipas kërkesës së personit të autorizuar, të tregojë biletën përkatëse të udhëtimit.

Neni 37

1. Transportuesi është i obliguar që të japë biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim, si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.
2. Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektojë itinerarin e linjës, të cilin duhet t'a ketë në automjet.

Neni 38

1. Personat përgjegjës të operatorëve transportues të udhëtarëve, nuk ju lejohej të parkojnë automjetin (autobusët/minibusët) jashtë stacionit të autobusëve në Malishevë, hyrja, parkimi dhe nisja bëhet vetëm nga stacioni i autobusëve Malishevë
2. Drejtuesi, personi përgjegjës i kompanisë është i obliguar para se të nisë automjetin të marrë biletën nga stacioni i autobusëve për dalje, dhe me këtë e dëshmon nisjen nga stacioni (nëse ka nevojë gjatë inspektimit nga inspektorët gjatë mbajtjes së vijës-relacionit).
3. Drejtuesi i automjetit nuk mund të nisë para se të jenë të mbyllura dyert e automjetit.

Neni 39

1. Udhëtarë i cili dëmton automjetin, është i detyruar të kompensojë dëmin.
2. Nëse udhëtarë refuzon të bëjë kompensimin, përkatësisht pagesën sipas paragrafit paraprak, është i detyruar që personeli i automjetit t'ia ofrojë të dhënat e sakta për identitetin e vet.
3. Udhëtarë mund të futë në automjet: bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, skitë dhe kompletin për peshkim.

Neni 40

1. Gjërat e gjetura në automjet i dorëzohen personelit të automjetit, i cili për këtë lëshon vërtetim me përshkrimin e shkurtër të sendeve të gjetura.
2. Nëse pronari i gjësëve të gjetura nuk gjendet gjatë vozitjes, personeli i automjetit ato ia dorëzon menjëherë shërbimit përkatës të transportuesit.
3. Transportuesi detyrohet që gjësendet e gjetura, në afat prej 2, ditësh, t'ia dorëzojë policisë.

Neni 41

Ndërprerja e trafikut

1. Në rast të ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve t'ua sigurojë daljen e sigurt nga automjeti.
2. Në rastet e prishjes së automjetit, nga paragrafi paraprak, transportuesi ka për obligim që udhëtarëve t'ua mundësojë vazhdimin e udhëtimit me automjet tjetër me të njëjtat bileta.

Neni 42

1. Gjatë transportit, ndalohej:
 - 1.1 pengimi i personelit të automjetit në kryerjen e detyrës;
 - 1.2 pirja e duhanit në automjet;
 - 1.3 hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar;
 - 1.4 futja në automjet e gjësëve, të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin;
 - 1.5 futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive;
 - 1.6 hyrja në automjet në gjendje të dehur;
 - 1.7 shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e sjellje të papërgjegjshme;
 - 1.8 hedhja e mbeturinave në automjet;
 - 1.9 hyrja në automjet në kundërshtim me nenin 33.1 të kësaj rregulloreje;

1.10 hyrja në automjet pas vërejtjes së personelit se nuk ka vende të lira.

1.11 udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjëren nga veprimet e cekura në këtë nen, largohet nga automjeti.

III. TRANSPORTI I UDHËTARËVE ME “TAKSI”

Neni 43

1. Transporti taksi lejohet të bëhet vetëm nëse është i regjistruar si biznes dhe posedon Vendim për ushtrimin e kësaj veprimtarie të lëshuar nga organet kompetente komunale.

2. Transporti autotaksi është transporti publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të marrveshjes apo taksimetrit.

3. Çmimi duhet të jetë për një km dhe e vërtetuar nga organi kompetent komunal dhe e vendosur në vend të dukshëm brenda në automjet.

4. Auto taksit janë të obliguar të kenë Taksimeterr, taksimetri duhet të jetë në gjendje të rregullt, atestuar dhe vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër si dhe i vendosur në vend të dukshëm në automjet.

5. transportuesi taksi është i obliguar që udhëtarin ta transportoj në relacionin sa më të shkurt të mundshëm.

6. Vendparkimin për Autotaksit e cakton Drejtoria komunale kompetente dhe autotaksit janë të obliguar të parkohen vetëm në këtë vendparkim.

7. Drejtoria kompetente cakton shumën vjetore për pages nga Autotaxit për parkimin e caktuar.

Neni 44

Kryerja e transportit taksi

1. Transporti taksi mund të kryhet vetëm me automjet me pesë (5) ulëse, katër plus një (4+1) ulëse dhe i cili i ka së paku katër dyer.

2. Automjeti sipas paragrafit 1, të këtij neni nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio ose gjysmerimorkio).

3. Transporti “auto-taksi”, zhvillohet brenda territorit të komunës i cili është i regjistruar për ushtrimin e veprimtarisë taksi.

4. Transporti “auto-taksi”, mund të kryhet edhe jashtë territorit të komunës, në çiftë se transporti fillon në territorin e komunës në të cilën është i regjistruar.

Neni 45

Kushtet për lëshimin e Vendimit për ushtrimin e veprimtarisë

1. Personi i cili dëshiron të paiset me Vendim për ushtrimin e veprimtarisë taksi përpos kushteve të parapara me dispozitat e kësaj Rregullore dhe legjislacionin në fuqi duhet të plotësojë edhe këto kushte;

1.1 të jetë banor i Komunës së Malishevës

1.2 të ketë të regjistruar biznesin me seli brenda territorit të Komunës së Malisheves

1.3 Personi që drejtonë automjetin me të cilin kryhet transporti “taksi” përpos kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe legjislacionin në fuqi, duhet të kenë së paku pesë (5) vite përvojë në drejtimin e automjetit

1.4 Libreza e qarkullimit të automjetit (te autotaksit) duhet të jetë në emër të biznesit.

2. Vendimin për ushtrimin e veprimtarisë Autotaksi e lëshon Drejtoria kompetente komunale pas plotësimit të kushteve sipas nenit 44, 45 të kësaj rregullore dhe lëshohet me afat për tri (3) vite.

3. Një muaj para se të skadojë afati i ushtrimit të veprimtarisë duhet të aplikoj për vazhdimin e saj.

IV. TRANSPORTI RRUGOR I MALLRAVE

Neni 46

1. Transporti rrugor i mallrave (më poshtë i quajtur: transporti i mallrave) kryhet si:
 - 1.1 transporti i mallrave për nevoja personale dhe
 - 1.2 transporti i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë).
2. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:
 - 2.1 licencën dhe
 - 2.2 fletëngarkesën.

Neni 47

Transporti i mallrave për nevoja personale

1. Ndalohet marrja me transport për nevoja personale, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë qellim;
2. Dispozita e pikës paraprake nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transporte të mallrave me qira.

Neni 48

1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja personale.
2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregojë se transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja personale.

Neni 49

1. Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja personale me automjet nga 3.5 deri në 6 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:
 - 1.1 fletëngarkesën dhe
 - 1.2 dëshminë, me të cilën mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja personale.

Neni 50

Transporti i mallrave me qira dhe pagesë

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë kryhet në bazë të Kontratës së lidhur në mes të qiradhënësit të automjetit transportues dhe qiramarrësit, i cili kontraktin transportin e mallrave.
2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë, operatori i transportit në automjet duhet të ketë:
 - 2.1 fletëngarkesën dhe
 - 2.2 kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.

V. MBIKËQYRJA

Neni 51

1. Mbikëqyrjen në transportin rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, brenda territorit të komunës, e bën Drejtoria e Inspektoratit .
2. Drejtoria e Inspektoratit është e autorizuar:
 - 2.1 të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor për ushtrimin e kësaj veprimtarie në pajtim me dispozitat e kësaj rregulloreje, në bazë të licencave dhe lejeve, të vërtetojë identitetin e operatorit transportues, personelit vozitës dhe të personave të tjerë përgjegjës për kryerjen e transportit;
 - 2.2 të urdhërojë mënjanimin e lëshimeve dhe mungesave në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë rregullore për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave;
 - 2.3 të përjashtojë nga qarkullimi automjetin, (autobus,minibus,kombibus,autotaksi) me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj rregulloreje, të caktojë vendparkimin, t'ia marrë lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.
3. Nëse të njëjtit operator të transportit i shqiptohet masa e gjobës mandatore për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 2, pika 3, të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi në kohëzgjatje deri në 5 ditë.
4. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, atij i merret shenja "TAXI" dhe numri i evidencës i regjistrimit të qarkullimit.
5. Me kalimin e afatit të masës, nga paragrafi 2, pika 2.3 dhe paragrafi 3 i këtij neni, inspektoriati ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra.

Neni 52

Konfiskimi i përkohshëm i automjetit

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, aty për aty me procesverbal vendos që automjeti i ndaluar të dërgohet, në shpenzime të mbajtësit të licencës,apo automjetit, në vende të caktuara për këto raste.

Neni 53

E drejta për ankesë

1. Kundër veprimit të Inspektoratit sipas neni 51 pikës 2.3, pikës 3, pikës 4 të këtij neni , neni 52 të kësaj rregullore mund të ushtrohet ankesë në Komisionin për shqyrtimin e ankesave në KK Malishevë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të procesverbalit.
2. Ankesa i dërgohet drejtpërdrejt Komisionit .
3. Ankesa nuk e ndalon ekzekutimin e vendimit kundër të cilit është paraqitur, përveçë kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe.

VI. KOHA MBROJTËSE

Neni 54

1. Koha mbrojtëse është intervali kohor në mes dy nisjeve nga e njëjta piknisje dhe relacion

2. Koha mbrojtëse në mes të dy nisjeve në të njëjtin relacion nuk mund të jetë më e shkurtër se 30 min distancë mes vete.
3. Linjat që nisen në të njëjtin drejtim por jo në piken zero të jetë 5-10 min. diferencë mes vete.

VII. DISPOZITAT NDËSHKIMORE

Neni 55

1. Personi (përgjegjës) fizik të cilët hasen në kundërshtim të nenit 4 pika 1 e kësaj rregullore, përveq masës ndëshkuese të parapar në nenin 51 të kësaj rregullore do të shqiptohet edhe gjyba mandatore:

- për autobus/minibus, gjyba mandatore në vlerë prej -----150€
- për kombitaksi, autotaksi, gjyba mandatore në vlerë prej ---- 50 €

2. Personat përgjegjës të (operatorit të kompanisë transportuese) personit juridik, nëse hasen në kundërshtim të nenit 6, 9 pika 1, neni 12, 13 pika 1,2,3, neni 14 pika 1, 2,4, neni 16, neni 17, 22, të kësaj rregullore do të shqiptohet gjyba mandatore

- për personin juridik (operatorin ekonomik) shuma prej ----- 200 €
- për personin përgjegjës të operatorit ekonomik shuma prej ---- 100 €

3. Nëse hasen në kundërshtim të nenit 31, 32, 34, 35, 37 pika 1, 38, të kësaj rregullore do të shqiptohet gjyba mandatore

- për personin juridik (operatorin ekonomik) shuma prej ----- 100 €
- për personin përgjegjës të operatorit ekonomik shuma prej ---- 50 €

Neni 56

1. Personave përgjegjës të cilët hasen në kundërshtim të nenit 18, 19, 20, 21 kësaj rregullore, do të shqiptohet gjyba mandatore:

- për personin juridik (operatorin ekonomik) shuma prej ----- 150 €
- për personin përgjegjës të operatorit ekonomik shuma prej ---- 50 €

Neni 57

Personi përgjegjës i stacionit të autobusit Malishev nëse bie në kundërshtim me nenin 24 pika 3 e kësaj rregullore do të shqiptohet gjyba mandatore

- Për subjektin (stacionin e autobusit) shuma prej ----- 250 €
- Personin përgjegjës të stacionit të autobusit shuma prej ---- 100 €

Neni 58

Personi përgjegjës i Autotaksit (biznes individual), nëse haset në kundërshtim të nenit 43 pika 3,4,5,6, neni 44 pika 2,3, të kësaj rregullore do të shqiptohet gjyba mandatore në vlerë prej -- 50 €

Neni 59

Personat përgjegjës nëse hasen në kundërshtim të nenit 47,48,49,50, të kësaj rregullore do të shqiptohen gjyba mandatore

- për personin juridik (operatorin ekonomik) shuma prej ----- 150 €
- për personin përgjegjës të operatorit ekonomik shuma prej ---- 100 €
- për personin fizik shumen prej -----100 €

Neni 60

Mbikqyrja dhe shqiptimi i denimeve mandatore dhe procedurat tjera kundervajtse

1. Mbikqyrjen e zbatimit të kësaj rregullore e bën Drejtoria e Inspektoratit
- 1.1 Të gjitha shqiptimet e dënimeve mandatore për kundërvajtje sipas kësaj rregullore i shqipton Inspektori i Komunikacionit, nëpunësit-inspektoret e Drejtorisë së Inspektoratit.
- 1.2. Përveq shqiptimit të gjobave mandatore të cilat janë të parapara në këtë rregullore, drejtoria e inspektoratit inicon fillimin e procedurave në gjykatat kompetente, për shkeljet që nuk janë parapara me këtë rregullore por që parashohen me ligje sektoriale.
2. Gjambat mandatore të parapara në këtë Rregullore janë paraparë si kundërvajtje të lehëta sipas nenit 29 paragrafi 5 i Ligjit nr.05/L-087 për Kundërvajtje.
- 2.(a). Shqiptimi i sanksioneve kundërvajtëse bëhet në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi për kundërvajtjet.
- 2.(b) Me rastin e pagimit të gjobës, në afatin e përcaktuar me urdhrin kundërvajtës, i dënuari lirohet nga pagimi 50% nga shuma e gjobës së shqiptuar.
- 2.(c). Për kundërvajtje të personit Juridik parashihet VETËM sanksioni kundërvajtës me gjobë.
- 2.(d). Për personat fizik, personat fizik që ushtrojnë biznes individual apo personat përgjegjës të personave juridik PËRVEÇ shqiptimit të gjobave parashihen edhe masa tjera të parapara sipas Ligjit për Kundërvajtje

Nëse personi kundërvajtës nuk e paguan në tërësi ose nuk e bën pagesën e gjobës në afatin e përcaktuar zbatohet procedura siç është e paraparë në Ligjin për Kundërvajtje

VIII. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 61

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja komunale 01/305 datë 15/03/2010

Neni 62

Në rast të mospajtimeve mes dispozitave të kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve të aplikueshme në Republikën e Kosovës që e rregullojnë këtë çështje, do të mbizotërojnë dispozitat e Ligjeve.

Neni 63

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hynë në fuqi sipas nenit 81 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale dhe pas shpalljes në web-faqen e Komunës së Malishevës.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Nr. 02/ _____

Datë ____/____/____

